

SHETITJA

KAZANI

E


T

BIBLIOTEKA
SHTETIT

854-32-F

B27

NDINI BARDHI



891.985-32-2

5

13 27

NDINI BARDHI

SHËTITJA E KAZANIT

(regime humoristike)

~~5654~~ 2004

2024.2



«ILAÇI» I OREKSIT...

Si zakonisht netve të dimrit edhe atë mbrëmje u mblozhëm në dhomën e zjarrit. Në krye të qoshes qëndron plaku im pensionist; pas tij i biri që jam vetë dora, axhustator; pranë meje djali i madh i imi, Beni, nxënës në klasën e pestë. Përballë skuadrës sonë qëndronte ekipi i femrave që kryesohej nga plaka, pensioniste, ime shoqe nëpunëse, ime bijë Ardiana pesë vjeçë, shoqe e ngushtë e maces së shtëpisë.

Megjithëse në dhomë ishin gjashtë vetë (duke mos llogaritur macen) mbretëronte qetësia. Secili merrej me një punë. Plaku pinte mendueshëm raki, unë lexoja romanin «Buka», Beni bënte detyrat, plaka kujdesej përgjellën, ime shoqe punonte triko, dhe Ardiana i bënte provën e përparsës shoqes së saj, maces.

Tek e fundit nuk qëndronim në heshtje. Atë e prishi plaku:

— Mor po, a keni oreks?

Unë hoqa sytë nga romani dhe ja drejtova tenxheres:

— Unë s'jam keq — thashë.

— Mua s'më hahet hiç — tha gruaja — dhe atë që e ha më duket sikur e hedh prapa kurrizit.

— Një herë në ditë një nafor dua — tha plaka duke treguar dy majat e gishtërinjve me gishtin e madh.

— Po ti, moj Ardiana? — pyeti plaku.

Ajo shikoi Benin që kishte lënë detyrat, pastaj qeshi si me turp.

Ardiana ankohet gjithmonë për pjatën e vogël.

— Unë të shqep — u krekos Beni.

— Kurse mua s'më hapet «sqepi» fare — psherëtiu plaku dhe ktheu gotën.

— Nga duhani e ke — tha plaka.

— Duhan pinë gjithë bota, moj.

— Pinë, por jo si ti, që ngrihe natën si kukudh dhe ndez cigaren.

Plaku bëri sikur s'e dëgjoi. Ra përsëri heshtje.

Mirëpo plaku kishte hallin e oreksit, prandaj përsëri foli:

— A ka ndonjë ilaç për oreksin?

— Plot farmacia — u përgjegj plaka.

— Moj po ilaçet e farmacisë i provova unë, s'ka tjetër? — Asnjë s'po përgjigjej.

— Ka — thashë unë.

— Vërtet?! — Plaku u kthye nga unë.

— Vërtet.

— Çfarë ilaçë është?

— Kur ta sjell do ta shikosh.

— Sa ditë vazhdon kura? — pyeti plaka.

— Dy javë, po mund ta vazhdosh edhe gjithmonë.

— Po më bën kurioz — tha plaku.

— Edhe ne — e pasoi gruaja, —po vërtet ta kthen oreksin?

— Jo vetëm oreksin, por edhe të forcon fizikisht, nuk sëmure, bile të zgjat edhe jetën.

— Mos more!? — U çudit plaka me lugë në dorë. — Po ai qenka ilaç. Duhet të bëjë shumë para.

— Jo dhe shumë.

Si hëngrën darkë, fjetën.

Të nesërmen në orën 5.30 fiks Beni (i porositur prej meje, si burizan dhe portier rezervë i shkollës që është) bëri zgjimin.

— Ej, ç'bën ore, zgjove dynjanë!

— Çohuni shpejt — thirra.

— Ç'është more!?

— Po preqatitemi të pimë ilaçin e oreksit.

U quan shpejt e shpejt plaku, plaka dhe ime shoqe,
pas tyre dhe Ardana. Hapa derën e apartamentit.

— Zbrisni shkallët të gjithë!

— Ku po na çon, o bir?

— Të pimë ilaçin e oreksit.

Plaku mori pallton.

— Lëre pallton — i thashë.

— Ftohem — tha ai i çuditur.

— Të nxeh ilaçi, pas meje! — zbritëm shkallët dhe
filluam të ecnim me vrap rrëth pallatit. Vraponim të
gjashtë.

— M'u zu fryma — u ankua plaku.

— Nga duhani e ke — tha plaka.

Ai u nxeh. Filloi të vraponte më tepër, derisa doli
në krye të rreshitit.

Duke ecur pranë plakut i shpjegova se një javë para
se të pihet ilaçi duhet pregetitur trupi me vrapime dhe
lëvizje.

Plaku u bind. Hodhi sytë prapa dhe ju hakërrua
plakës:

— Hidhi këmbët, moj, se nuk do të të bëjë fajde
ilaçi...

Kur po i vinim për të dytën herë rrötull pallatit,
ndodhi ajo që edhe unë s'e prisja.

Gjithë pallati ishte ngritur më këmbë, ca veshur, ca
pa veshur, të trembur më prenë rrugën:

— Ç'ka ndodhur?! — pyesnin të habitur.

— Hajdeni me vrap me ne — u thirra.

I ramë edhe një herë rrötull pallatit.

— Ç'keni që i bini me vrap, ç'ju ka ndodhur?

— Asgjë — tha plaku — bëjmë gjimnastikë.

Tjetri zgurdulloi sytë.

— Gjimnastikë?!

— Po të duash futu në rresht — i fola.

— Futu, se ngordhe si miu — i tha im atë.

Ai u largua duke murmurit me vete. Shumë të
tjerë e pasuan, por kishte edhe nga atë, që atë mëngjez
bënë gjimnastikë me ne.

Kaloi java. Me familjen tonë u bashkuar edhe tetë familje të tjera të pallatit.

Një darkë, pasi kishin kaluar 2 javë, u mblodhën përsëri në dhomën e zjarrit. Secili merrej me një punë. Ardiana kishte vënë në rresht tri kukllat e saj dhe u bënte gjimnastikë. Ora ishte 20.

— Opo do hamë darkë sonte — pyeti plaku me pardurim.

— Ç'u bëre si Ardiana — i tha plaka, — po ti ken grënë katër herë deri tani!

— Nesër do të të sjell ilaçin e oreksit — i thashë plakut.

— Çfarë?!

— Ilaçin që ju premtova...

— Jo, joooo! Mos e bëj këtë!

— Pse? — pyeta gjoja i çuditur.

— Sepse, nuk e dëgjon se deri tani kam ngrënë katër herë bulkë, dhe ilaç më duhet mua tani, që të ha edhe dërrasat e dollapit të bukës. Pastaj... — plaku tundi kokën si me turp — pastaj ilaçin e pimë ne.

— Kush jua solli?

— Gjimnastika.

S'm'u mbajt të qeshurit...

REPORTAZHI IM

Edhe një ditë më mbeti nga dorëzimi i reportaznit tim në redaksi. Tani unë nuk po mendoja më për reportazhin, por për formën e triblimit që do t'i bëja redaksisë për të dalë nga sikleti; por, kot nuk thonë se ç'të sjell minuta nuk të sjell moti.

Atë ditë, si zakonisht në mëngjez u futa në klub për të pirë kafen, kur takoj xha Veliun, pensionistin më të vjetër të qytetit tonë.

— Po ç'u bëre, xha Veli?

— Ja, more, jesh andej nga fshati — më tha duke më përqafuar.

— Mirë që të gjeta, se litarin në grykë e kam.

— S'ka litar që na mbyt ne jo! Po kalamajtë si i ke?

— Kalamajtë? Léri kalamajtë e lagjes, po kam një hall të madh.

Xha Veliu çapëliti sytë...

— Më kërkojnë ata të gazetës një reportazh për qytetin tonë si ka qenë...

— Qëndisua, ti për shkollë je marshalla!

— Mirë thua, po nuk njoh të kaluarën.

— Atëhere pyet ti, të flas unë, shkruaj ti.

— Shumë mirë. Atëhere jemi gati të fillojmë.

Plaku nxori qesen e duhanit, mbushi çibukun prej shtogu sa një xhezve dyshe dhe i dha zjarr. Mbas mori mirë «kalldaia» foli.

— Urdhëro e pyet.


«Urdhëro e pyet», por çfarë të pyes. M'u ngatërrua radha e nyetjeve. Hë po, m'u kujtua:

-- Xha Veli, pyetja e parë është: «Si ka qenë qyteti i ynë para 25 vjetëve?»

Pensionisti hoqi çibukum nga goja, e cila i mbeti i hapur nga habia:

— Për cilin qytet po pyet, or bir?

— Po ja për qytetin tonë.



- Shkruaj. Asgjë.
- Si ta shkruaj asgjë? Habia kaloi tek unë...
- Asgjë, hiçgjë, zero.
- Aaa! E kuptoj ku e ke fjälën, mos e krahaso me qytetin sot, më thuaj si ishin shtëpitë, kasollet ose brrakat...
- Turçë s'të fola. Shkruaj asgjë për pyetjen e parë dhe vërtitu shpejt në pyetjen e dytë!
- S'e kuptoj këtë zeron tënde, dua të them se një bazë ka patur...
- Po, këtu ke të drejtë, një bazë ka patur, ka qenë toka, dheu që lindi dhe rriti bijt e saj dhe ata pastaj e stolisën këtë tokë me këto që na shikojnë sytë.
- Këtë e shënova si hyrje të reportazhit, por me sa dukej letra do të më ngelej e bardhë.
- Xha Veliu thithte llullën i qetë, duke shikuar lapsin tim që po flinte.
- Ku mbeti?
 - Te pyetja e dytë.
 - Folë!
 - Sa banorë ka patur qyteti ynë më 1944?
- Plaku zgurdulloi sytë dhe i ra çibuku nga dora:
- Bijë e xhaxhait, i thirri kamerieres, hiqi një kafe shqeto këtij djalit, më duket se ka zjarrllék — ukthye nga unë dhe më vuri dorën në ballë.
 - Digjesh pak, biri im. Na është prishur dhe ajo fambrika e akullit të vije një copë në kokë.
- «Mos më keqkuptoi», mendova. Ja përsërita dhe një herë pyetjen shkoqur.
- Mirë — tha — shkruaj! — Mirë që e kuptoi pyetjen, mendova dhe zgjova lapsin.
 - Ama, dëgjo: saktë, s'i mbaj mend.
 - Afërsisht.
 - 4 miliard e pesëqind milion... (më ra lapsi nga dora)... mushkonja.
 - E kam fjälën...
 - Prit... 1501 ujqër, duke përfshirë këtu dhe beun, që e kishte irat këtë tokë...

Koka më vinte rrrotull, më dukej sikur në dritaren karshi po rrrotulloheshin pallatet 4-5-katëshe me 12 mijë banorët.

— 2700 lepuj, mos harro edhe fashistët italianë, që organizuan krosin masiv pikërisht këtu tek është pallati i kulturës...

— Xha Veli, mua s'më duhen lepujt...

— Epo tjetër gjë s'ka patur. Ferrat të duhen?

— Jo.

— Drizat, gorricat?

— Jo, jo.

— Atëhere pi kafen se t'u ftoh!

— Po reportazhi mbeti gjysmë, ata shokët...

— Mbushe me të sotmen — hidh sytë: Pak pallate ke, mbushe me apartamente, mbushe me shkolla, mbushe me kopshte, çerdhe, spitale, mos harro uzinën, kinemanë, që e eshperoj me plakën gjithmonë...

— Pi kafen, mos u mendo!

— Mendohem se «Reportazhi» u bë për në hosten.

— Ashtu bëje, dërgoje në «Hosteni».

— Po gazeta?

— Gazetës t'i dërgojë një reportazh tjetër «Hosteni».